



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 70019-00246-00-2025 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2025-835 Vendimi**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Ilir PANDA	Kryesues
Albana BOKSI	Anëtare
Medi BICI	Anëtar

sot në datën 22.05.2025, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë e për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

OBJEKTI: Parashtrim mosmarrëveshje kompetence

BAZA LIGJORE: Neni 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenet 13, 75/a, 83, 89, 90 dhe 112 të Kodit të Procedurës Penale, ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; neni 11 i ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Në lidhje me çështjen penale me palë:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër.

TË PANDEHUR: Ramazan Dekovi, Agustin Gjeta, Stivigliano Ndou...,

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale të "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit", parashikuar nga neni 298/3-4 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 591/1 të vitit 2024, në ngarkim të të pandehurve Ramazan Dekovi, Agustin Gjeta dhe Stiviljano Ndou, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga nenet 298/3 dhe 298/4 të Kodit Penal; si dhe pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr. 591/1 të vitit 2024, regjistruar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtimit i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga nenet 290/4 dhe 291 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 331, 329/a dhe neni 328, pika 1, shkronja “e” dhe “f” të Kodit të Procedurës Penale.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtare Albana Boksi dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, në datën 04.11.2024 ka depozituar në atë gjykatë, kërkesën me objekt: *“Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 591/1 të vitit 2024, në ngarkim të të pandehurve Agustin Gjeta, Stiviljano Ndou dhe Ramazan Dekovi të akuzuar për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, të parashikuar nga neni 298/4 dhe 298/3 të Kodit Penal; si dhe pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr. 591/1 të vitit 2024, regjistruar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuara nga nenet 290/4 dhe 291 të Kodit Penal.*

2. Në seancën e datës 26.02.2025, pas shpalljes së përbërjes së trupit gjykues, në momentin procedural të kërkesave paraprake, gjyqtari i seancës paraprake pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, ka vlerësuar se nuk ka kompetencë lëndore për të shqyrtuar kërkesën e prokurorisë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 591/1 të vitit 2024, në ngarkim të të pandehurve Agustin Gjeta, Stiviljano Ndou dhe Ramazan Dekovi për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit", të parashikuar nga neni 298/4 dhe 298/3 i Kodit Penal, si dhe pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr.591/1 të vitit 2024, regjistruar për veprën penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" dhe "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" të parashikuara nga nenet 290/4 dhe 291 i Kodit Penal. Gjyqtari i seancës paraprake kryesisht ka konstatuar se lloji i bashkëpunimit të të pandehurve të sipërcituar është i veçantë, referuar nenit 28 të Kodit Penal paragrafi 4 i të cilit parashikon: *“Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar.”*

3. Në lidhje me këtë konstatim të gjyqtarit të seancës paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, si edhe mbrojtësit e të pandehurve, kanë mbajtur qëndrimin se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka kompetencë lëndore për të shqyrtuar kërkesën.

4. **Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër**, me vendimin nr. 217/21-2025-214, datë 26.02.2025, pa i kthyer aktet prokurorisë, ka vendosur:

- Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për gjykimin e kërkesës penale me nr. 1053 regjistri themeltar, datë regjistrimi 04.11.2024, me kërkesues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me objekt dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 591/1 të vitit 2024 dhe pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr. 591/1 të vitit 2024, me të pandehur Agustin Gjeta, Stiviljano Ndou dhe Ramazan Dekovi.
- Dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

4.1 Në lidhje me këtë disponim, kjo gjykatë ndër të tjera ka argumentuar se, *bazuar në aktet e fashikullit nr. 591/1 të vitit 2024, rezulton se kemi të bëjmë me një grup të strukturuar kriminal... Këta shtetas në bazë të veprimeve të dokumentuara në fashikull kanë krijuar një strukturë veprimtare, e cila dhe në bazë të dërgesave të parave, nuk ka vetëm pjesëmarrje të shtetasve të huaj që kontribuonin për realizimin e saj, por edhe shtetas shqiptarë. Sa më sipër u arsyetua, gjykata në rastin konkret vlerëson se kompetente për të shqyrtuar çështjen objekt gjykimi është Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shkak të formës së veçantë të bashkëpunimit, si grup i strukturuar kriminal.*

5. Gjykata e Shkallës së Parë e për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. 83, datë 11.04.2025, ka disponuar:

- Ngritjen e çështjes së mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore midis gjyqtarit të seancës paraprak pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe gjyqtarit të seancës paraprake pranë Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për gjykimin e kërkesës penale nr. 83 akti, datë 17.03.2025, me kërkuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër; objekt: “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 591 të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurve Ramazan Dekovi, Agustin Gjeta dhe Stiviljano Ndou, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga nenet 298/3 dhe 298/4 të Kodit Penal.
- Dërgimin e kopjes së akteve Gjykatës së Lartë.
- Një kopje e këtij vendimit t'i dërgohet kërkuarit Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe gjyqtarit të seancës paraprake pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

5.1 Gjykata e Shkallës së Parë e për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka parashtruar (referim i përmbledhur): “... Gjykata çmon të theksojë se në rastin konkret, gjykata e seancës paraprake pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër në respektim të nenit 332/d pika 3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), duhet t'i kishte kthyer aktet Prokurorisë në kushtet kur kjo e fundit nuk ka reflektuar pas kërkesës së gjyqtarit të seancës paraprake për korrigjimin e akuzës, ku bën pjesë edhe “shtimi i një akuze”. Duke i kthyer aktet prokuroria në zbatim të vendimit arsyetimit të gjyqtarit të seancës paraprake do të duhet të veprojë sipas nenit 28 të KPP nën titullin “Kalimi i akteve një prokurorie tjetër”, ku parashikohet shprehimisht se: “1. Kur gjatë hetimeve paraprake prokurori çmon se vepra penale është në kompetencën e një gjykate të ndryshme nga ajo pranë së cilës ushtron funksionet e tij, ia kalon menjëherë aktet prokurorisë pranë gjykatës kompetente. 2. Prokurori që ka marrë aktet, në qoftë se çmon se duhet të procedojë prokuroria që ia ka dërguar aktet, njofton Prokurorin e Përgjithshëm, i cili, pasi shqyrton aktet, cakton se cila prokurori duhet të procedojë dhe njofton prokuroritë e interesuara. 3. Nëse prokurori çmon se vepra penale është në kompetencën e Prokurorisë së Posaçme ose merr dijeni se pranë kësaj prokurorie po zhvillohen hetime për të njëjtin fakt dhe në ngarkim të të njëjtit person, ia kalon aktet Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili, pasi i shqyrton ato, vendos pranimin e akteve ose i ridërgon ato në prokurorinë e mëparshme. Kjo e fundit ka detyrimin të pranojë aktet. 4. Veprimet hetimore të kryera para kalimit ose caktimit të bërë sipas paragrafit 1 dhe 2, janë të vlefshme dhe mund të përdoren në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji.”. Pra, në rastin konkret pasi t'i ktheheshin aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër kjo e fundit duhet të shpallte moskompetencën dhe t'i kalonte aktet Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

5.2 Duke mos u ndjekur kjo rrugë dhe duke mos pasur një vendimmarrje nga prokuroria për të korrigjuar akuzën, duke shtuar grupin e strukturuar kriminal, formalisht akuza në rastin konkret është ajo që është përcjellë për gjykim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër në ngarkim të të pandehurve Ramazan Dekovi, Agustin Gjeta dhe Stiviljano Ndou, të cilët janë akuzuar për kryerjen e veprës penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga nenet 298/3 dhe 298/4 të Kodit Penal. Kjo vepër penale nuk është në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) rithekson se, kompetenca funksionale përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejtë (*shih vendimin njësesues të Kolegjit Penal nr. 23, datë 27.07.2021*).

7. Kodi i Procedurës Penale (KPP) në Kreun II, Seksionin V, titulluar “Mosmarrëveshjet për kompetencat”, nenet 89, 90 dhe 91 të KPP ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë. Përkatësisht, neni 89/1 i KPP parashikon se: *“Ka mosmarrëveshje, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata, në të njëjtën kohë, marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtit person”*. Neni 90 i këtij Kodi parashikon parashtrimin e mosmarrëveshjes në këtë mënyrë: *“1. Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Parashtrimi paraqitet në sekretarinë e njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje, me kërkesë të shkruar e të motivuar, të cilës i bashkohet dokumentacioni i nevojshëm. 2. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes, merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit. 3. Gjykata që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje”*. Neni 91 i KPP, parashikon se: *“1. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Gjykata e Lartë me vendim. Gjykata merr të dhënat, aktet dhe dokumentet që i çmon të nevojshme. 2. Vendimi u komunikohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje, prokurorive përkatëse, të pandehurit dhe palëve private”*. Ndërsa, neni 83 i KPP, parashikon se: *“1. Moskompetenca lëndore ngrihet, edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të procesit. 2. Moskompetenca tokësore dhe ajo që rrjedh nga bashkimi i procedimeve për shkak lidhje, mund të ngrihet ose të kundërshtohet, vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor”*.

8. Kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion, të parashikuara nga rendi juridik si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar. Kompetenca është një kusht procedural i vlefshmërisë së procesit gjyqësor dhe i akteve të realizuara gjatë tij, në kuptimin që “një gjykatë jo kompetente nuk mund të kryej asnjë veprimtari procedurale”. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është ndër të tjera parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar, duke cenuar parimin kushtetues të ligjshmërisë apo të gjykimit të një personi dy herë për të njëjtën vepër (*ne bis in idem*), të parashikuar përkatësisht në nenet 4/1 dhe 34 të Kushtetutës. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar. Pra, një ndër parimet e procesit të rregullt ligjor është dhe parimi se gjykata duhet të jetë e caktuar me ligj. Kjo do të thotë se ajo kërkohet të jetë një gjykatë kompetente, të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej

ligjit. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e ka përkufizuar një gjykatë si një organizëm që ushtron funksione gjyqësore, e krijuar me ligj për të përcaktuar çështjet brenda kompetencave të saj në përputhje me procedura të kryera në mënyrë të përcaktuar. Çdo gjykatë që shqyrton një çështje duhet të jetë e krijuar me ligj. Kushti që një gjykatë të krijohet me ligj zbatohet jo vetëm për kuadrin institucional, por edhe për përbërjen specifike të saj në një çështje të caktuar (*shih vendimin nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata Kushtetuese ka një praktikë të konsoliduar lidhur me parimin “gjykata e caktuar me ligj”. Kjo gjykatë ka theksuar se, shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi “gjykatë” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se, mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm dhe pretendimi për respektimin e kësaj kompetence mund të ngrihet si nga i pandehuri/i gjykuari, ashtu edhe kryesisht në çdo fazë të procesit. (*shih vendimet nr. 31, datë 01.12.2005; nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 22, datë 22.07.2009; nr. 27, datë 24.06.2013; nr.53, datë 09.12.2013; nr. 62 datë 19.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në zbatim/parashikim të dispozitave procedurale si më sipër, si dhe në referim të parashtrimeve/qëndrimit të mbajtur nga gjykatat respektive për çështjen objekt shqyrtimi, konstatohet ekzistenca e mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore, pasi dy gjykata të ndryshme, të të njëjtës shkallë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk pranojnë të gjykojnë çështjen penale, me objekt: “*Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 591 të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurve Ramazan Dekovi, Agustin Gjeta dhe Stiviljano Ndou të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga nenet 298/3 dhe 298/4 të Kodit Penal, si dhe pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr. 591/1 të vitit 2024, regjistruar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtimit i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga nenet 290/4 dhe 291 i Kodit Penal.”* Në rastin konkret gjykata që ka deklaruar moskompetencën - (*Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër*), me vendimin nr. 217/21-2025-214, datë 26.02.2025, ka vlerësuar se bazuar në aktet e fashikullit nr. 591/1 të vitit 2024, rezulton se bashkëpunimi mes shtetasve të akuzuar është në formën e një grup të strukturuar kriminal. Sipas gjyqtarit të seancës paraprake pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, shtetasit e akuzuar, në bazë të veprimeve të dokumentuara në fashikull kanë krijuar një strukturë veprimtarie, e cila dhe në bazë të dërgesave të parave, nuk ka vetëm pjesëmarrje të shtetasve të huaj që kontribuonin për realizimin e saj, por edhe shtetas shqiptarë. Sa më sipër, kjo gjykatë ka çmuar se kompetente për të shqyrtuar çështjen objekt gjykimi është Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shkak të formës së veçantë të bashkëpunimit, si grup i strukturuar kriminal.

11. Ndërsa gjykata që ka parashtruar këtë mosmarrëveshje për kompetencë lëndore - (*Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë...*), ka vlerësuar se në këtë fazë të procesit (seancë paraprake), vendimmarrja për të shtuar një akuzë të re i takon vetëm organit të prokurorisë. Në situatën që gjyqtari i seancës paraprake vlerëson se duhet shtuar një akuzë e re, fton prokurorin e çështjes për korrigjimin e akuzës, dhe nëse ky i fundit nuk reflekton, disponon për kthimin e akteve prokurorit. Sipas gjyqtarit të seancës paraprake në Gjykatën e Posaçme fillimisht duhet disponuar kthimi i akteve prokurorit, i cili në zbatim të arsyetimit të vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, do të duhet të veprojë sipas nenit 28 të KPP, nën titullin “Kalimi i akteve një prokurorie tjetër”. Pra, në rastin konkret pasi t’i ktheheshin aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër kjo e fundit duhet të shpallte

moskompetencën dhe t'i kalonte aktet Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Duke mos u ndjekur kjo rrugë dhe duke mos pasur një vendimmarrje nga prokuroria për të korrigjuar akuzën, duke shtuar grupin e strukturuar kriminal, sipas gjyqtarit të seancës paraprake pranë Gjykatës së Posaçme, formalisht akuza në rastin konkret është ajo që është përcjellë për gjykim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër në ngarkim të të pandehurve Ramazan Dekovi, Agustin Gjeta dhe Stiviljano Ndou, të cilët janë akuzuar për kryerjen e veprës penale "Ndiqja për kalim të paligjshëm të kufijve", parashikuar nga nenet 298/3 dhe 298/4 të Kodit Penal. Kjo vepër penale nuk është në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

12. Për sa paraqitet më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret duhen mbajtur në vëmendje parashikimet e dispozitave procedurale penale si: neni 332/ç, neni 332/d, neni 34, neni 372, neni 373, neni 374, neni 375 të KPP¹. Nga interpretimi logjik dhe sistematik i këtyre dispozitave procedurale, Kolegji çmon se pavarësisht orientimeve të gjykatës mbi cilësimin e faktit penal, deri në fazën e procesit penal - e cila korrespondon/përket fazës së seancës paraprake, organi i vetëm kompetent që mund të marrë vendimin për ndryshimin dhe shtimin e akuzës apo të një rrethane rënduese që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim, është prokuroria, e cila merr vendim dhe ja komunikon të pandehurit. Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Pra, në këtë fazë të procesit – (seancë paraprake), gjykata/gjyqtari i seancës paraprake nuk ka kompetencë të bëjë kryesisht ndryshimin e cilësimit juridik apo korrigjimin e akuzë. Natyrisht, gjyqtari i seancës paraprake orienton prokurorin, duke e ftuar të saktësojë/korrigjojë akuzën, por ligji procedural në këtë fazë paragjyqësore parashikon reagimin dhe vendimmarrjen e prokurorit mbi orientimin e gjyqtarit të seancës paraprake. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata disponon për kthimin e akteve duke përcaktuar drejtimit dhe orientimet përkatëse. Nëse

¹ Neni 332/ç Vendimi për plotësimin e hetimeve: 1. Kur çmon se hetimet paraprake nuk janë të plota, gjykata urdhëron plotësimin e tyre, duke përcaktuar drejtimin dhe, kur është rasti, edhe aktet që duhet të kryhen. Kur konstaton akte të pavlefshme ose prova të papërdorshme, gjykata i deklaron ato me vendim dhe, kur është e mundur, urdhëron përsëritjen e tyre. Gjykata cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë dhe datën e seancës së re. 2. Vendimi i njoftohet drejtuesit të prokurorisë.

Neni 332/d, Ndryshimi i akuzës në seancën paraprake: 1. Kur gjatë seancës paraprake fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, rezultojnë një vepër tjetër penale, sipas shkronjës "b", të paragrafit 1, të nenit 79, apo del një rrethanë rënduese që nuk është përmendur, prokurori ndryshon akuzën dhe ia komunikon të pandehurit të pranishëm. Kur i pandehuri nuk është i pranishëm, akuza e re i komunikohet mbrojtësit të tij, të cilit i jepen jo më shumë se 10 ditë kohë për të komunikuar me të pandehurin. 2. Kur gjatë seancës paraprake në ngarkim të të pandehurit del një fakt i ri penal që nuk është përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe për të cilin duhet të procedohet kryesisht, gjykata lejon komunikimin e akuzës për faktin e ri, kur prokurori paraqit kërkesë dhe i pandehuri jep pëlqimin. Në rast të kundërt, gjykata i kthen prokurorit aktet që lidhen me akuzën e re dhe njofton drejtuesin e prokurorisë. 3. Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t'i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë.

Neni 34, Marrja e cilësisë së të pandehurit: 1. Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit. 2. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit. 3. Cilësia e të pandehurit rimerret kur prishet vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit. 4. Shfuqizuar.

Neni 372, Ndryshimi i akuzës: 1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për gjykim dhe gjykimin i tij është në kompetencën e asaj gjykate, prokurori ndryshon akuzën dhe procedon me akuzën përkatëse.

Neni 373, Akuza për një vepër tjetër: 1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një vepër penale tjetër që ka lidhje me atë që gjykohej, sipas nenit 79 germa "b", ose një rrethanë rënduese që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim, prokurori i komunikon të pandehurit veprën penale ose rrethanën, por me kusht që gjykimin të mos jetë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Neni 374, Akuza për një fakt të ri: 1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një fakt i ri në ngarkim të të pandehurit që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim dhe për të cilin duhet proceduar kryesisht, prokurori procedon në format e zakonshme, duke tërhequr dosjen për të vazhduar hetimet paraprake. Megjithatë, në qoftë se prokurori kërkon, gjykata mund të lejojë shqyrtimin në të njëjtën seancë kur i pandehuri jep pëlqimin dhe nuk dëmtohet shpejtësia e procedimit.

Neni 375, Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale: 1. Me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose viktimja akuzuese, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj. 2. Kur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata vlerëson se fakti për të cilin akuzohet i pandehuri mund të ketë cilësim juridik më të rëndë se ai që ka bërë prokurori ose viktimja akuzuese, njofton palët mbi këtë mundësi dhe u jep kohën e nevojshme për t'u mbrojtur. Palët kanë të drejtë të paraqesin prova të reja. 3. Kur gjykimin zhvillohet në mungesë të të pandehurit, sipas nenit 352, të këtij Kodi, gjykata zbaton rregullat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të tij.

ndryshimi i cilësimit juridik do të ishte kompetencë funksionale e gjyqtarit të seancës paraprake, nuk do të kishte kuptim logjik dhe juridik vendimi për kthimin e akteve prokurorisë dhe njoftimi i drejtuesit të prokurorisë.

13. Vetëm gjykata/gjyqtari i themelit mund të bëjë ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal sipas përcaktimeve të nenit 375 të KPP. Pra, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose viktimja akuzuese, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj. Kur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata vlerëson se fakti për të cilin akuzohet i pandehuri mund të ketë cilësim juridik më të rëndë se ai që ka bërë prokurori ose viktimja akuzuese, njofton palët mbi këtë mundësi dhe u jep kohën e nevojshme për t'u mbrojtur. Palët kanë të drejtë të paraqesin prova të reja.

14. Sa më sipër, si dhe duke mbajtur në vëmendje rrethanat procedurale, faktike dhe juridike të çështjes në shqyrtim, Kolegji vlerëson se gjykata që ka ngritur mosmarrëveshjen për kompetencë lëndore, ka vlerësuar drejt se në rastin konkret rruga e drejtë procedurale, në respektim të dispozitave të KPP, është që gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të shtojë akuzë të re kryesisht. Në kushtet kur gjyqtari i seancës paraprake vlerëson se, duhet saktësuar apo korrigjuar akuza e atribuuar të pandehurve, duhet të ftojë prokurorin për të bërë korrigjimin përkatës, nëse ky i fundit nuk reflekton mbi orientimet e gjykatës, atëherë gjykata/gjyqtari i seancës paraprake i kthen aktet prokurorit. Në vijim, referuar kësaj situatë/gjendje procedurale të procedimit –(kur gjykata i kthen aktet prokurorit), është prokuroria që në zbatim të vendimit arsyetimit të gjyqtarit të seancës paraprake do të duhet të veprojë në raport me saktësimin/korrigjimin e akuzës, e në vijim sipas nenit 28 të KPP, mund të disponojë për kalimin e akteve një prokurorie tjetër/prokurorisë kompetente. Në rast se në një situatë tillë procedurale organi i prokurorisë nuk vepron konform parashikimeve të nenit 28 të KPP, por i drejtohet gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq - (neni 331 të KPP), gjykata/gjyqtari i seancës paraprake disponon me një nga format e parashikuara nga nenin 332/dh të KPP, duke i dhënë fund fazës së seancës paraprake. Është gjykata/gjyqtari i themelit që gjatë/pas shqyrtimit gjyqësor të provave dhe kontradiktoritetit/debatit gjyqësor në tërësi, mund të bëjë ndryshimin e cilësimit juridik sipas përcaktimeve të nenit 375 të KPP, në këtë mënyrë duke riparuar eventualisht edhe çdo pasaktësi të akuzës apo cilësimit juridik të faktit nga ana e prokurorisë në këtë drejtim.

15. Kolegji në vijim të kësaj analize, vlerëson se në këtë fazë të procesit “seancë paraprake”, gjykata/gjyqtari nuk mund të shtojë kryesisht një akuzë të re siç ka vepruar në rastin në shqyrtim, gjykata që ka deklaruar moskompetencën lëndore, e cila në vijim-(më pas) ka shpallur/deklaruar moskompetencën pikërisht për shkak të shtimit të një akuze, gjykimi i të cilës është në kompetencë lëndore të gjykatave të posaçme. Vërehet se gjykata që deklaruar moskompetencën, në seancë paraprake ka ngritur/evidentuar një akuzë të re, ndaj të pandehurve, duke mos i dhënë mundësinë organit të akuzës për të ndryshuar/saktësuar cilësimin juridik të faktit penal, gjithashtu as të pandehurve mundësinë të paraqesin argumentet dhe të realizojnë mbrojtjen lidhur me këtë fakt, e për më tepër, pa iu nënshtruar një shqyrtimi/debati gjyqësor të provave.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi, vlerësimi i gjykatës që ka parashtruar këtë mosmarrëveshje për kompetencë - (Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar), është i bazuar në ligj dhe për rrjedhojë, shqyrtimi i çështjes penale në fjalë, me objekt: *“Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 591 të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurve Ramazan Dekovi, Agustin Gjeta dhe Stiviljano Ndou, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Ndiqja për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga nenet 298/3 dhe 298/4 të Kodit Penal”, është në kompetencën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.*

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 97 të Kodit të Procedurës Penale;

V E N D O S I

- 1- Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore, ndërmjet Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, duke përcaktuar se gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes penale: “ (nr. 83 akti, datë 17.03.2025), me kërkesë: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër; objekt: “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 591 të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurve Ramazan Dekovi, Agustin Gjeta dhe Stiviljano Ndou, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga nenet 298/3 dhe 298/4 të Kodit Penal)”, është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.
- 2- Vendimi t'u komunikohet gjykatave në mosmarrëveshje.

Tiranë, më datë 22.05.2025

Vërtetohet njësia me origjinalin. Adm.Gjyq.VD